



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 240, Datë 21.12.2020

“MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERDY ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KALIS” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2138 KW”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 13 “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr.109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/10 prot, datë 16.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “ERDY ENERGY” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 205, date 04.12.2020, vendosi te fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ERDY ENERGY” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Kalis”, me vendodhje në përroin e Shmilit, Kuterman, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.
- Në vijim të kësaj vendimmartje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/42 prot., datë 04.12.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ERDY ENERGY” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 1232/1 prot., datë 11.12.2020, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa kërkuar nga ERE shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1232/2, prot., datë 14.12.2020, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencën e prodhimit të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi në respektim të rregullores sipërcituar është tërësisht i plotësuar.
- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Librazhd, (datë 21.09.2025) shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
- Shoqëria pasi të pajiset me miratimin final për heqjen nga fondi pyjor kullësor publik të sipërfaqjes së përcaktuar më sipër, duhet ta depozitojë atë në ERE.
- Në përfundim të afatit të Lejes së përdorimit të burimit ujqor, (datë 25.04.2022) shoqëria të depozitojë në ERE të rifreskuar në datë, jo më vonë se një muaj pas rinovimit të afatit të saj.
- Kontrata nr. 1945 REP., nr. 885/3 KOL., datë 04.09.2017, *“Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Kalis”, me kapacitet prodhues 1958 kW, në ujrat rrjedhes se lumit te Shmilit, dege e Lumit Shkumbin, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan”,* e lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Mbajtësit të miratimit shoqërisë “ERDY ENERGY” sh.p.k., ka një afat 49- vjeçar, por nga ana tjetër ERE në zbatim të nenit 38 të Ligjit *“Për sektorin e energjisë elektrike”,* i ndryshuar dhe nenit 5 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike”,* nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ERDY ENERGY” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kalis”, me kapacitet të instaluar 2138 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Pas përfundimit të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Librazhd, (datë 21.09.2025) shoqëria duhet të depozitojë kontratën me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.
3. Shoqëria pasi të pajiset me miratimin final për heqjen nga fondi pyjor kullësor publik të sipërfaqjes së përcaktuar më sipër, ta depozitojë atë në ERE.
4. Pas përfundimit të afatit të Lejes së përdorimit të burimit ujqor (datë 25.04.2022), shoqëria të depozitojë Lejen me afate të rifreskuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

5. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI